

Etimologjia

Arbanizmat, latinizmat, dhe otomanizmat

1. Ka mundsi që shqipja pati huazuum rreth 100 fjalë prej latinishtes së lashtë. Shqipja ka edhe disa fjalë të ngjashme me rumunishten. Aty kah shekujt 7-10^{te}, Arbania u pat dominuom prej gjuhëve sllave. Kah shekulli i 16^{te} në gjuhën shqipe nisën me hy otomanizma (fjalë arabe, persiane, e turke). Megjithatë, burimi kryesor i huazimeve për elitat shqiptare, ashtu si ai i elitave të tjera europjane, ka qenë gjithmonë gjuha latine.

2. Ashtu si në gjuhët tjera (anglisht, frangjisht) që patën kaluom një perioidë të gjatë pa gramatika, edhe fjalët **shqpe** janë të shkurta, konkrete, dhe *të pazëvendsueshme*. Në anën tjetër, **latinizmat** janë të gjata e abstrakte, prandaj ato duhen zëvendsua kudo të jetë e mundun. **Otomanizmat** mund të përdoren me karakterizua personazhe periferike, p.sh., ata që banojnë thellë në hinterland.

Fjalë Shqipe	Latinizmë	Otomanizmë
atë, tatë	patër	babë
Avë (G, T)	spirit	ymër
e blertë, e gjelbër		jeshile; boj hoxhe
eja	arrij	hajde
emtë		teze, hallë
falemnderit		ej v'Alláh
flamur		bajrak
Flamurtar		Bajraktar
fqinjë		komshi
grindje		sherr
i zbrazët		bosh
íri		inatë
kalë, pelë		gjog
këpucë		kundra
kraholl		xhamadan
kryesí		bashkí
kryetar	perfekt	bashkiak
kuartë		çerek
kunat		baxhanak
leje	përmit	
me grishë		joshë
me qëllim, nergut		enkas
mendeshë		dado / dadë
mik		mysafir

mirë	e favorëshme	
ndaj	proporcioj	
orë		sahat
papritmazi		befas
parzëm		gjoks
përballë		karshi
përlim, uha		borxh
pjesë		hise
plastik		kauçuk
plis		qeleshe
rrugë e verbët		qorr sokak
shkop i trashë		dajak
shqisoj	përceptoj	
syze		gjyslykë
tirq		çakçirë
tjetri	subsekuenti	
ungj		axhë, xhaxha, dajë
zëje	profesion	zanat

3. Fjalët e gjuhës shqipe tingellojnë konkrete, kuptimplota; dhe nuk japin as ton mendjem-adh (latinizma, anglizma) as ton të periferik (otomanizma).

4. Fjalët që sosin më -ok, -ak, tingëllojnë otomane edhe kur nuk janë të tilla. Fjalët që sosin më -li, -llëk, dhe -é janë dhe tingëllojnë otomane, p.sh.,

abeng, alle, axhë, babë, bakër, barut, bash, bashibazuk, bashkí (kryesí), basmë, bast, batak, batall, batallinë, baxhanak, baxhë, beqçi, bixhoz, bixhozli, bojë, bojaxhi, borxh, bosh, boshllëk, bozë, braktis, byrazer, çajre, çanak, çantë, çapkën, çapraz, çarshí, çatall, çatí, çatís, çatrafiloj, çausb, çebre, çekan, çekiç, çelik, çengel, çerek, çesmë, çiban, çibuk, çiflig, çift, çifte, çifteli, çikrik, çilek (rrush), çinar, çini, copë, dollap, devlet, dugajë, dybek, dyfek, dylber, dylbi, dymlek, dynym, dyqan, dysbeme, dyst, dyzen, fishek, gjerdan, gjerdek, gjergjef, gjevrek, gjezdis, gjiriz, gjog, gjoja, gjoks, gjol, gjyslykë, gurabí, halá, hallë, hapsanë, haram, harbut, hasëm, hava, hise, jatak, jazë, jazëk, jel, jele, jelek, jereví, jeshil, joshë, joshje, kajmak, kajsí, kallauz, kapardisem, kapí, kaps, kapsallis, karabinë, karabojë, karadake, karafil, karagjoz, karakoll, kardun, karshi, kasabá, kasap, kasavet, kat (dykatëshe), katil, katran, kaush, kavall, kazan, kazmë, këllë, këllëf, kërbac, kobure, koçi, koçobash, kumar (lojë), kumarxhi, kundra (këpuçë), llokum, mushtulluk, panxbar, panxhë, papuçe, pará, penxheré, peshqesh, qeleshe, qorr, rast, sham, shargí, sheqerpare, shebër, sofër, sokak, taban, tallava, tamam, tamërr, tarabá, tegel, tek, tel, telashe, telatin, telef, telendis, telhá, tellall, teneqé, tenxheré, tepsí, teqé, terbjët, terezí, tërhan, ters, terzí, teslim, teze, vatan, xham, xhamadan, xhambaz, xhanëm, xhaxha, xhelat, xhenaze, zarf.

5. Fjalët latine i japin gjuhës një ton superior a të sofistikuom, i cili, ka herë që mund të tingëllojë edhe i zbrazët ose pretendues, p.sh., *Shkodër* vs. *Skutari*. Duke ditë që 2000 vjet më parë gjuha shqipe nuk kishte /s/, kur dëgjon fjalën /skutari/ të vjen me u strukë. Përse u dashka me përdorë një fjalë italiane (Skutari) edhe kur shqiptari shkruan në anglisht.

Krahaso: *Përceptova një monstër fantastik me Pashë një përbindësh të çuditëshëm*. Në fjalinë e parë jo vetëm që mungon konkretizmi, por fjalët e huaja mund të mos kuptohen prej lexuesve.

6. Anglizmat: Të nevojëshme në lidhje me teknologjinë, p.sh., *email, podcast*, por jo *test, uikend, show, girlfriend, boyfriend*.